

PROGRAMI I TRANSPARENCES 2015



I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik (këtej e tutje ASHA) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së.

ASHA do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën nr. 2 të nenit nr.5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASHA-s, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.asha.gov.al si dhe në mjediset e zyrave të saj.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentacionin e veprimtarisë së ASHA-s. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet.

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e ASHA-s është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së ASHA-s janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: ASHA ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e ASHA-s dhe përkatësisht: Ligji Nr. 9048 datë 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturorë" i ndryshuar, VKM Nr. 724, datë 21.05.2008 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik"; VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" Vendimi Nr. 2, datë 30.01.2009 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë "Rregullore mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut, kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike, kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte privatë"

4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Drejtori i Agjencisë.

6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- ✓ i plotë;
- ✓ i saktë;
- ✓ i përditësuar;
- ✓ i thjeshtë në konsultim;
- ✓ i kuptueshëm;
- ✓ lehtësisht i aksesueshëm;
- ✓ i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit me Nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit".

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ASHA vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.asha.gov.al, dhe në zyrat e saj, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

Strukturën organizative të autoritetit publik;

1. Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore të funksionimit , të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për aplikim,

adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për aplikim, si dhe procedurat e përkatëse;

Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;

2. Listën e anëtarëve të KKA, dhe vendimet periodike të saj, sipas afatit ligjor.
3. Listen e subjekteve të licencuar në fushën e arkeologjisë dhe kontaktet e tyre. Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet vjetore të shërbimeve arkeologjike, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit; Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
4. Buxheti vjetor i ASHA-s dhe pas miratimit të tarifave, plani të ardhurave nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet.
5. Informacion për rregjistrin e prokurimit publik sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik".
6. Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
7. Informacion mbi Zonat arkeologjike brenda zonave të banuara, Kufinj të dhe Rregulloria e Administrimit të Parqeve Arkeologjike, sipas VKM përkatëse.
8. ASHA, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të saj në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë; Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo njoftime që prekin veprimtarinë e ASHA-s në lidhje me operatorët dhe publikun si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga ASHA.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

Nr	Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza Ligjore	Dokumenti / Permbajtja	Afati kohor për publikim	Menyra e publikimit	Sektori Përgjegjës për përgatitjen e materialit apo disponimin e tij.
1	Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe organika e ASHA-s	VKM 724 date 21.05.2008 dhe Urdher Nr.22 i kryeministrit date 25.01.2014	VKM/ Skeme organizative, Organika/ Urdher	Pas botimit ne fletore zyrtare	www.asha.gov.al Menu-RRETH NESH-Struktura/ LEGJISLACIONI- Ligji dhe VKM	Sektori i Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese
2	Keshilli Kombetar i Arkeologjise, funksionimi, Perberja e Keshillit Kombetar te Arkeologjise	VKM 725 date 21.05.2008 / URDHER Nr.17 date 28.01.2014	VKM / Urdher	Pas botimit ne fletore zyrtare	www.asha.gov.al Menu-LEGJISLACIONI- Ligji dhe VKM	Sektori i Arkives dhe Sekretarise Teknike/ Juristi
3	Akte ndërkombëtare/konventa te ratifikuara qe prekin funksionimin e ASHA-s	Konvente Nr. 9806 date 17.09.2007/ Ligj Nr. 10027 date 11.12.2008	Konvente/ Ligj	Pas botimit ne fletore zyrtare	www.asha.gov.al Menu-LEGJISLACIONI-Konventa	Sektori i Arkives dhe Sekretarise Teknike/ Juristi
4	Ligji "Per Trashegimine Kulturore" dhe vendimi "Per organizimin dhe funksionimin e ASHA"	Ligji 9048 date 07.04.2003 i ndryshuar/ VKM 724 date 21.05.2008	Ligj/Vendim	Pas botimit ne fletore zyrtare	www.asha.gov.al Menu-LEGJISLACIONI- Ligji dhe VKM	Specialisti i autorizuar per administrimin e faqes web
5	Vendime KKA 2008-2015	Ligji Nr.119/2014,	Vendime KKA	5 dite nga data e zbardhjes	www.asha.gov.al Menu-LEGJISLACIONI-Vendime KKA...	Sektori i Arkives dhe Sekretarise Teknike
6	Informacion mbi: 1. Procedurat per aplikim per projekte zhvillimi 2- Procedurat per aplikim per projekte kerkimore-shkencore 3. Lista e individeve dhe shoqerive private te licencuara	Ligji Nr 107/2014 dhe Ligji 9048 date 07.04.2003 i ndryshuar/ Vendim 2 date 30.1.2009	Listat e aplikimeve/ Listat e dokumentacionit/ Listat e individeve dhe shoqerive private te licencuara	Pas miratimit te titullarit ne perputhje me ndryshimet ne legjislacion	www.asha.gov.al Menu-RRETH NESH-Sektori i Arkivit dhe Sekretarise Teknike	Sektori i Arkives dhe Sekretarise Teknike
7	Te dhena per ASHA, adresa, orari punes, emri dhe kontaktet e koordinatorit per te drejten e informimit	Ligji Nr.119/2014,	Te dhena	Pas miratimit te Koordinatorit te ASHA-s	www.asha.gov.al Menu-PROGRAMI I TRANSPARENCES-Koordinatori per te drejten e informimit	Koordinatori per te drejten e informimit
8	Raporte vjetore te sherbimeve arkeologjike	VKM 724 date 21.05.2008	Botim periodik vjetor	Pas botimit	www.asha.gov.al Menu-AKTIVITETE-Raporte Vjetore ASHA	Specialisti i autorizuar per administrimin e faqes web
9	Buxheti i ASHA-s	Ligji Nr. 9936 date 26.06.2008	Tabela e Buxhetit	Pas miratimit te ligjit	Ne faqen zyrtare ne Menu-RRETH NESH-Sektori i Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese	Sektori i Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese
10	Informacion mbi procedurat e prokurimit	Ligj Nr. 9643 date 20.12.2006	Rregjistri i parashikimeve te prokurimeve publike	Pas dergimit ne APP	www.asha.gov.al Menu-RRETH NESH-Sektori i Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese	Sektori i Finances dhe Sherbimeve Mbeshtetese
11	Rregjstri i kerkesave dhe pergjigjeve	Ligji Nr.119/2014, neni 8	Tabele	Pas miratimit te Programit te transparences	www.asha.gov.al Menu-PROGRAMI I TRANSPARENCES	Koordinatori per te drejten e informimit
12	Zonat arkeologjike brenda qendrave te banuara/ Kufinjtë dhe rregullorja e administrimit te Parqeve Arkeologjike	VKM	Vendim/ Rregullore	Pas botimit ne fletore zyrtare	www.asha.gov.al Menu-LEGJISLACIONI-Zonifikime	Specialisti i autorizuar per administrimin e faqes web
13	Kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut	Vendim KKA Nr. 2 date 30.01.2009	Vendim	Pas miratimit nga KKA	www.asha.gov.al Menu-LEGJISLACIONI-Rregullore	Specialisti i autorizuar per administrimin e faqes web
14	Institucione Partnere	Ligji 9048 date 07.04.2003 i ndryshuar/ VKM 724 date 21.05.2008	Marreveshje	Pas antetaresimit	www.asha.gov.al Menu- INSTITUCIONE PARTNERE	Specialisti i autorizuar per administrimin e faqes web

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ASHA vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.asha.gov.al, dhe në mjediset e zyrave të saj për takime me publikun, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “*Programi i Transparencës*”.

VI.MONITORIMI

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik monitoron zbatimin e ligjit për trashëgimin kulturore, aktet nën ligjore në zbatim të tij dhe të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e saj, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje që lidhen me shërbimet funksionale të ASHA-s dhe vendimarrjes së KKA-së.